



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 07 Shkurt 2018

Njoftim

Fondi për sigurim shëndetësor **Njofton** ofruesit e shërbimeve shëndetësore që ju përkasin veprimtarive nga mjekësia e përgjithshme, stomatologjia e përgjithshme, kujdesi shëndetësor specialistik – konsultativ, laboratorive dhe kujdesi shëndetësor specialistik – konsultativ stomatologjik, se është në procedurë të përpilimit të Aneks marrëveshjeve për zbutjen e disa gjobave kontraktuale edhe atë:

1. Anekset për ndyshimin dhe plotësimin e marrëveshjeve për mjekësi dhe stomatologji të përgjithshme i referohet uljes së gjobave për pagesat e pajustificuara shtesë të personave të siguruar, e cila është në vlerë prej tre kapitacioneve mujore nga pjesa fikse.

Kjo gjobë kontraktual është e paraparë vetëm në Marrëveshjen për kryerjen dhe pagesat në kujdesin shëndetësor parësor të mjekësisë dhe stomatologjisë së përgjithshme, gjë që i vendos në pozitë të pa-barabartë me institucionet shëndetësore që u përkasin veprimtarive të tjera.

Me qëllim që t'a zbutim politikën e gjobave, gjithnjë duke pasur parasysh nivelin e barazimit të gjobave të institucioneve shëndetësore private nga kujdesi shëndetësor parësor nga të gjitha veprimtaritë, me anë të këtyre Aneks marrëveshjeve, gjoba kontraktuale në vlerë prej tre kapitacioneve mujore nga pjesa fikse transformohen në gjobë kontraktuale në vlerë prej 1/2 e një kapitacioni mujor nga pjesa fikse.

2. Aneks marrëveshja për ofrimin dhe pagesat e shërbimeve shëndetësore të kujdesit shëndetësor specialistik – konsultativ dhe Ankes marrëveshja për ofrimin dhe pagesat e shërbimeve shëndetësore të analizave laboratorike (LU1) nga kujdesi shëndetësor specijalistik – konsultativ, me udhëzim të mjekut amë, dhe Aneks marrëveshja për ofrimin dhe pagesat e shërbimeve shëndetësore nga kujdesi shëndetësor specijalistik – konsultativ stomatologjik i referohet precizimit të mënyrës së përcaktimit të bazës, gjatë vendosjes së gjobave kontraktuale.

Gjegjësisht, në marrëveshjet aktuale gjoba përcaktoheshte nga buxheti i fundit i paguar. Me anë të marrëveshjes ishte e paraparë përputhshmëria kuartale (tremujore) nga vlera e buxhetit. Në këto raste gjoba mund të përcaktoheshte në vlerë më të lartë nga sa është buxheti mujor, mvarësisht nga vlera e fundit e faturuar dhe e paguar për muajin përkatës.

Për të mundësuar qasje të barabartë gjatë përcaktimit të gjobave, me këto Aneks marrëveshje përcaktohet baza në të cilën vendoset që gjoba kontraktuale të jetë në vlerë prej 1/3 nga buxheti i përgjithshëm i kuartalit të parë të paguar.

Aneks marrëveshja hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të saj nga dy palët kontraktuale.

Me respekt, FSSHIM